



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

A.nr.606/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Skende Çoçaj, kryesues, Kymete Kicaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e kandidatit për deputet nga radhët e Subjektit Politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Petrit Hajdari, me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Përthinë, për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në Komunën e Prizrenit, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.02.2025, merr këtë:

V E N D I M

HEDHET E PASAFATSHME ankesa A.nr.606/202 , e parashtruar nga kandidati për deputet nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, Petrit Hajdari paraqitur kundër Qendrës Komunale të Numërimit në Komunën e Prizrenit, për shkak të parregullsive gjatë numërimit, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 09 Shkurt 2025.

A r s y e t i m

Me datë 23.02.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesën Anr.606/2025, nga kandidati për deputet Petrit Hajdari nga radhët e Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, në të cilën pretendohet se më datë 22 shkurt ka pranuar informata dhe shqetësime nga, qytetarët Ridvan Islamaj, Zyrije Islamaj dhe Selver Islamaj se pas numërimit të kutisë së votimit (në Qendrën Komunale të Numërimit në Komunën e Prizrenit) në vendvotimin 2066/02, edhe pse që të tre kanë votuar për kandidatin në fjalë, i cili pretendon se pas publikimit të rezultateve nga KQZ në faqen zyrtare rezulton që në këtë vendvotim të ketë marr vetëm një votë . Më tej në ankesë theksohet se kanë dyshime të arsyeshme se të njëjtit përkundër votave të tyre , e kanë njoftuar se kandidatura e kandidatit në fjalë është votuar edhe nga disa miq dhe familjar të të njëjtëve si dhe kanë ofruar bashkëpunim për të argumentuar faktin se në vendvotimin 2066/02 në Komunën e Prizrenit ka më shumë vota sesa ato të publikuara në web faqen zyrtare të KQZ-së. Ku rezulton se kandidati në fjalë ka marr vetëm një votë. Një pretendim të tillë e argumenton edhe deklaratat e tyre si dhe letërnjoftimet e tyre, ne mënyrë që PZAP të verifikoj nëse të njëjtit janë regjistruar si votues në vendvotimin 2066/02 në Komunën e Prizrenit dhe të vërtetohet fakti se në këtë vendvotim përkundër i votave nuk është bërë në mënyrë të saktë përkritazi me kandidaturën e kandidatit në fjalë. Andaj ne ankesë thekson se nga argumentet e ofruara me lart kërkojmë që ne baze të nenit 13, par 10.i të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave, ashtu që të urdhërohet KQZ, që të rinumëroj fletëvotimet në vendvotimin 2066/02, në Komunën e Prizrenit , me qëllim të evitimit të çfarëdo tjetërsimi të vullnetit të popullit.

Provë: Rezultatet e votave për kandidat në vendvotimin 2066/02 në Komunën e Prizrenit; Deklarata e përpiluar nga z. Selver Islamaj, e datës 23 shkurt 2025.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 24.02.2025, nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) theksohet se KQZ, pas shqyrtimit të ankesave dhe pretendimeve të palës ankuese në lidhje me kërkesën jep sqarimet/ përgjigjet si më poshtë: Duke u bazuar në nenin 105 paragrafi 1 të Ligji Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ankesat lidhur me Qendra Komunale të Numërimit (QKN) dhe QNR dorzohen në PZAP Brenda 48 orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar. Bazuar në Ligjin për zgjedhjet e përgjithshme nenin 105 paragrafi 1, Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar. Po ashtu në përgjigje në ankesë theksojnë se lidhur me pretendimet e palës ankuese se ka pasur parregullsitë gjatë procesit të numërimit të votave në vendvotimin Nr.2066/02 në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN), në Prizren, është e pasafatshme, pasi që me datën 19.02.2025 në ora 17:20 është përmbyllur procesi i numërimit të votave të kandidatëve për deputetë dhe verifikimit të votave të subjekteve politike nga formularët e plotësuar në vendvotime më 9 shkurt 2025, në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në Komunën e Prizren dhe se i gjithë materiali zgjedhor duke përfshirë edhe kamerat e sigurisë, të përdorura për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 09 shkurt 2025, janë dorëzuar nga Komisioni Komunal i Zgjedhjeve (KKZ) të Komunës së Prizrenit më datën 22.02.2025, në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), duke shtuar se pas shqyrtimit të deklaratave të votuesit të bashkangjitura në ankesën e ankuesit, kanë gjetur se të njëjtat nuk janë të mjaftueshme për tu konkluduar se në QKN në Prizren ka pasur parregullsi dhe rrjedhimisht pretendimet ankimore, mbështeten në pohime të qytetarëve të caktuar të cilat nuk janë argumentuar, andaj theksojnë, se vota është e fshehur, dhe se publikimi i saj, shpërfaq vullnetin, e çdo votuesi në fletëvotim dhe se është në kundërshtim me parimin kushtetues të fshehtësisë së votës, dhe se një veprim i tillë në asnjë mënyrë nuk mund të merret si fakt provues, ashtu që një pretendimi i tillë se një votues pohon faktin se ka votuar në vendvotimin e përfshirë në ankesë nga ankuesi. Edhe pse ankesa është e pas aftëshme në përgjigje në ankesë theksojnë se edhe pse pala ankuese i referohet parregullësive në QKN, ku si rezultat i parregullësive ankuesi është dëmtuar me vota, nuk qëndrojnë sepse nuk janë shpallje e rezultateve përfundimtare, dhe se këto janë forma të rezultateve të plotësuara në Qendrat Komunale të Numërimit nga ekipet e numërimit dhe të gjithë të interesuarit mund të shohin rezultatet e çdo vendvotimi duke shfletuar kopjet e formularëve me qëllim të rritjes së transparencës për procesin zgjedhor. Andaj publikimi i formularëve nga QKN-të, sipas komunave ka qenë proces i vazhdueshëm, ku pas përfundimit të numërimit, formularët e plotësuar skanohen dhe se të njëjtit publikohen gradualisht në ueb faqen e KQZ-së.

Në përgjigje në ankesë theksojnë se nga KQZ shpallen rezultatet përfundimtare të procesit zgjedhor, pas përfundimit të numërimit të të gjitha fletëvotimeve nga vendvotimet e rregullta; fletëvotimeve nga votimi me kusht; fletëvotimet nga votimi i personave me nevoja të veçanta; fletëvotimeve nga votimi jashtë Kosovës; vendosjes për ankesat eventuale nga PZAP dhe Gjykata Supreme dhe pas përfundimit të të gjitha procedurave në QNR, andaj rezultati i publikuar është i ankueshëm nga subjekte politike dhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numërimin e votave të tyre. Kështu që palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të LPZ, mund të ushtrojnë ankesë në afatin brenda dyzet e tetë (48) orëve në

PZAP. Si provë në përgjigje është: Njoftimi i dërguar nga Menaxheri i Qendrës Komunale të Numërimit (QKN) në Prizren , Ystet Bytyqi, ZE KKZ-Prizren, dërguar me e-mail më datën 23.02.2025, lidhur përmbyllur QKN-së.

Paneli pasi që shqyrtoj ankesat dhe përgjigjen në ankesë vlerësoi se :

- Ankesa është e pasafatshme.

Në këtë rast, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, konstatohet se kandidati për deputet nga radhët e Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Petrit Hajdari ka dorëzuar ankesën në PZAP, më datë 23.02.2025, ku ka pretenduar se ka pranuar informata dhe shqetësime nga, qytetaret e lartëcekur se pas numërimit të kutisë së votimit (në Qendrën Komunale të Numërimit në Komunën e Prizrenit) në vendvotimin 2066/02, edhe pse që të tre kanë votuar për kandidatin në fjalë, i cili pretendon se pas publikimit të rezultateve nga KQZ në faqen zyrtare rezulton që në këtë vendvotim të ketë marr vetëm një votë .

Megjithatë, ankesa është parashtruar pas afatit ligjor për paraqitjen e ankesës, sipas nenit 105 paragrafi 1 i LZP-së, ku afati për dorëzimin e ankesave lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR dorëzohen ,me shkrim pran PZAP-së brenda 48 orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar, ndërsa ankesa është dorëzuar në PZAP më datë 23.02.2025, në ora 14:31, kurse nga hetimi i ndërmarr nga PZAP-i dhe nga përgjigja e KQZ-së, procesi i numërimit në QKN është përfunduar më datën 19.02.2025 në orën 17:20, që do të thotë se ankesa është dorëzuar pas afatit të paraparë ligjor.

Paneli, ka gjetur se ankesa e parashtruar nga kandidati për deputet nga radhët e Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Petrit Hajdari, është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën ligjore të nenit 105 paragrafi 1 i LZP-së, *ku afati për dorëzimin e ankesave lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR dorëzohen*, me shkrim pran PZAP-së brenda 48 orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar.

Paneli sqaroi se palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të LPZ, mund të ushtrojnë ankesë në afatin brenda dyzet e tetë (48) orëve në PZAP edhe pasi që KQZ shpalle rezultatet përfundimtare të procesit zgjedhor.

Paneli gjeti se i njëjti është ushtruar pas afatit ligjor, dhe nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 105 paragraf 1 i LZP-së, dhe nenit 9 paragrafi 5 nën paragrafi 5.5 të Rregullës 01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A.nr. 606/2025 më datën 24.02.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.